

MENAXHIMI I GJELBËR NË NIVEL KOMUNAL



MENAXHIMI I GJELBËR NË NIVEL KOMUNAL

Botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci 94,
Prizren & Bulevardi Nënë
Tereza 30B H1 Nr.5, Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Ky hulumtim është realizuar nga EC Ma Ndryshe, i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, (Sida) përmes Programit të saj "Human Rightivism" që implementohet nga Community Development Fund – CDF. Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.

Mbledhja e këtyre të dhënave nga zyrtarët përgjegjës përfshin periudhën kohore Qershor–Gusht 2020



Nëntor, 2020

PËRMBAJTJA


- 1 ● Hyrje
- 3 ● 1. Identifikimi i ndotësve të ajrit, tokës dhe ujërave nëntokësore
- 4 ● 1.1. Kontribuuesit e ndotjes së ajrit
- 5 ● 1.2 Ndotja e tokës dhe ujërave nëntokësore të shkaktuara nga aktivitetet bujqësore
- 6 ● 2. Mbëltimi dhe mirëmbajtja e fidaneve të reja
- 6 ● 2.1 Mbëltimi i fidaneve të reja
- 7 ● 2.2. Analizat fitosanitare
- 8 ● 2.3 Mirëmbajtja e fidanëve në hapësira urbane
- 9 ● 3. Monitorimi dhe menaxhimi i mbeturinave të ngurta dhe atyre mjekësore
- 11 ● 4. Prerjet dhe zjarret ilegale pyjore
- 11 ● 4.1 Prerjet ilegale pyjore
- 12 ● 4.2 Zjarret pyjore të identifikuar në disa nga komunat e Kosovës përgjatë tri viteve të fundit
- 14 ● 4.3 Pyllëzimi i tokave të dëmtuara nëpër Komuna në tri vitet e fundit
- 15 ● 5. Profesionistët Mjedisor
- 16 ● 6. Rekomandime
- 18 ● Për EC

HYRJE

Hulumtimi “Menaxhimi i gjelbër në nivel komunal” ka për qëllim që t'i njoftoj qytetarët me angazhimin e drejtorive komunale në fushën e mjedisit. Në këtë dokument paraqiten edhe krahasimet ndërmjet komunave.

Ky hulumtim është zhvilluar përmes intervistave me anë të kërkesave që EC ka parashtruar tek zyrtarët kompetentë. Të përfshirë në hulumtim kanë qenë **9 Komuna:**

- **Komuna e Ferizajit;**
- **Komuna e Gjakovës;**
- **Komuna e Gjilanit;**
- **Komuna e Malishevës;**
- **Komuna e Mitrovicës;**
- **Komuna e Pejës;**
- **Komuna e Prishtinës;**
- **Komuna e Prizrenit;**
- **Komuna e Suharekës.**



Nga **Komuna e Ferizajit, Gjakovës dhe Pejës**, EC ka arritur që të sigurojë përgjigje vetëm nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë, ndërsa Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës në Ferizaj dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike në Gjakovë e Pejë nuk i janë përgjigjur kërkesës.

Nga **Komuna e Gjilanit** është arritur qasje vetëm në disa nga pyetjet e parashtruara nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë.

Nga **Komuna e Malishevës** i janë përgjigjur kërkesave të EC, Drejtoria e Shërbimeve Publike kurse Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural nuk janë përgjigjur.

Nga **Komuna e Mitrovicës** EC ka pranuar përgjigje edhe nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturë, edhe nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Poashtu edhe në **Komunën e Suharekës** është marrë përgjigje nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mjedis dhe Emergjencë si dhe nga Drejtoria e Bujqësisë.

Ndryshe nga këto dy Komuna, **në Prizren** nuk është arritur që të mirret përgjigje nga asnjëra drejtori ku janë parashtruar kërkesat, gjegjësisht në Drejtori të Shërbimeve Publike dhe Drejtori të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Nga **Komuna e Prishtinës**, EC ka arritur të merr përgjigje nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtoria e Parqeve, ndërsa nga Drejtoria e Inspektionit nuk është arritur të mirret përgjigje.

Hulumtimi është i ndarë në 6 kapituj, përkatësisht:

- **Identifikimi i ndotësve të ajrit, tokës dhe ujërave nëntokësore**
- **Mbëltimi, analizat fitosanitare dhe mirëmbajtja e fidaneve të reja**
- **Monitorimi dhe menaxhimi i mbeturinave të ngurta dhe atyre mjekësore**
- **Prerjet dhe zjarret ilegale pyjore**
- **Profesionistët mjedisor**
- **Rekomandime**

1 Në kapitullin e parë rreshtohen ndotësit kryesorë të ajrit në Komunat që kanë qenë të përfshira në hulumtim, si dhe renditen akterët e ndotjes së tokës dhe masat që mirren për parandalimin e tokës dhe ujërave nëntokësore që shkaktohen nga aktivitetet bujqësore.


2 Në kapitullin e dytë zyrtarët e intervistuar të përfshirë në hulumtim kanë shprehur me statistika sasinë e fidanëve që janë mbëltuar përgjatë tri viteve të fundit (2018, 2019 dhe 2020) dhe kanë njoftuar se nga kush dhe si mirëmbahen këto fidane të reja. Poashtu në këtë kapitull flitet edhe për analizat fitosanitare për të cilat janë përgjigjur zyrtarë nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.

3 Monitorimi dhe menaxhimi i mbeturinave të ngurta dhe atyre mjekësore është kapitulli i tretë i cili adreson sistemin e menaxhimit të mbeturinave të ngurta në Kosovë sipas Raportit të Progresit për vitin 2020 nga Komisioni Evropian, si dhe shtjellon mënyrën se si menaxhohen dhe monitorohen këto mbeturina nga Komunat e intervistuar nga EC.

4 Si problem që ende mbetet problematikë në vendin tonë janë prerjet dhe zjarret ilegale pyjore, të cilat shtjellohen në kapitullin e katërt. Ky kapitull liston fletëparaqitjet penale dhe kundërvajtëse të Komunave dhe dëmet e shkaktuara nga kjo dukuri.

5 Kapitulli 5 liston drejtoritë, sektorët dhe zyrtarët që janë me profesion mjedisor e që janë përgjegjës për çështjet ambientale në Komunat e Kosovës.


6 Ndërsa kapitulli 6 përmban disa rekomandime për veprimet që duhet të ndërmerren nga institucionet përgjegjëse për të zbutur ndikimet nga burimet e ndotjes.



1. IDENTIFIKIMI I NDOTËSVE TË AJRIT, TOKËS DHE UJËRAVE NËNTOKËSORE

Cilësia e ajrit vazhdon të përbëjë një kërcënim të madh për shëndetin. Ndotja e pakontrolluar, veçanërisht nga termocentralet e vjetruara, ngrohja shtëpiake, trafiku, emetimet industriale dhe djegia e mbeturinave dhe materialeve të tjera toksike, kërkojnë masa urgjente. Masat për të zbatuar ndalimin e qymyrit për ngrohje nuk janë efektive dhe subvencionet duhet të futen për format e tjera të ngrohjes. Planet e cilësisë së ajrit nuk janë përgatitur ende për zonat në të cilat nivelet e ndotësve qartë tejkalojnë vlerat kufitare.

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf



Aktivitetet industriale janë një burim presioni mbi mjedisin në formën e emetimeve në atmosferë dhe ekosistemet e ujit, gjenerimin e mbeturinave dhe konsumin e burimeve. Në komunën e Suharekës sektori i përpunimit të gomës dhe lëkurave, prodhimi i llaqrave dhe ngjitësve ndërtimor të parafabrikantëve nga betoni dhe asfalti del se janë nga kontribuesit më të mëdhenj të mjedisit sipas zyrtarëve të kësaj komune. Në komunën e Prishtinës ndotjes në disa raste po i kontribuojnë bizneset të cilat si lëndë të parë për zhvillim të biznesit përdorin lëndë djegëse të kualitetit të dobët. Mirëpo këta të fundit si hap të parë për problemin e ndotjes së ajrit kanë marrë disa iniciativa:

- **Bashkëpunimin me të gjitha institucionet që merren me problemin e ndotjes së ajrit;**
- **Me qëllim të monitorimit të cilësisë së ajrit Komuna ka bërë vendosjen e gjashtë sensorëve në gjashtë lagje të qytetit si dhe gjatë këtij viti, viti 2020, do ta bëjë zgjerimin edhe me dy sensorë të tjerë;**


- **Është përgatitur plani i mobilitetit i cili tashmë vetëm ka filluar të realizohet, plan ky i cili do të ndikojë drejtpërsëdrejti në zvogëlimin e ndotjes së ajrit që vjen nga komunikacioni;**
- **Është duke u punuar shumë në shtimin e hapësirave të gjelbra dhe mbjelljen e drurëve dekorativë si dhe është duke u përgatitur plani për qytetin e gjelbër në të cilin do të përfshihen projekte të cilat do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në përmirësimin e cilësisë së ajrit.**

Sa i përket problemit të ndotjes së ajrit nga ngrohja, Komuna e Prishtinës me projekte të veçanta dhe në bashkëpunim me institucionet përkatëse është duke bërë zgjerimin e rrjetit të ngrohjes me kogjenerim si dhe mundësinë e instalimit të ngrohjes edhe me ngrohje solare. Pastaj edhe në ndërtimet e reja që po realizohen, Komuna e Prishtinës përmes raporteve për LMK, kërkesë të veçantë ka që të respektohen kriteret e kërkuara për planifikimin e hapësirave të gjelbra nga PZHK dhe mënyra e ngrohjes të jetë ngrohje ekologjike.

1.1 KONTRIBUESIT E NDOTJES SË AJRIT

Ndër ndotësit më të mëdhenj të ajrit sipas zyrtarëve në Komunën e Mitrovicës është Deponia e Trepçës (PIM) e cila është në zonën urbane të qytetit dhe fatkeqësisht është hot-spoti më i madh mjedisor në Ballkan. Ndotjes poashtu në këtë komunë sipas zyrtarëve i kontribuojnë edhe trafiku i dendur dhe veturat e vjetra, mospastrimi i rregulltë i rrugëve, trotuareve dhe hapësirave publike dhe përdorimi i thëngjillit.

Në Komunën e Malishevës si ndotës të ajrit konsiderohen të jenë gurthyesit, furrat e gëlqeres dhe djegia e qymyrit për ngrohje nga qytetarët. Drejtoria e Inspektoratit e përcjellin në vazhdimësi sektorin e gurthyesve për implementimin e rregullativës ligjore, standardeve të operimit dhe implementimin e kushteve teknike, kontrole të përbashkëta edhe me nivelin qendror. Për sektorin e furrave të gëlqeres, janë dhënë pëlqimet nga drejtoria kompetente që pjekja e gëlqeres të bëhet vetëm me drunjë. Shpeshherë Drejtoria e Inspektoratit ka hasur në djegie të gomave, e në këto raste Inspektoriati ka shqiptuar gjoba dhe ka ndërmarrë veprime ligjore të parapara.



1.2 NDOTJA E TOKËS DHE UJËRAVE NËNTOKËSORE TË SHKAKTUARA NGA AKTIVITETET BUJQËSORE

Ndotja e tokës shkaktohet zakonisht nga prania e kimikateve ksenobiotike (të bëra nga njerëzit) ose ndryshime të tjera në mjedisin natyror të tokës. Zakonisht shkaktohet nga aktiviteti industrial, kimikatet bujqësore ose hedhja e pahijshme e mbeturinave. Kimikatet më të zakonshme të përfshira janë hidrokarburet e naftës, hidrokarburet aromatike polinukleare, tretësit, pesticidet, plumbi dhe metalet e tjera të rënda. Shqetësimi për ndotjen e tokës buron kryesisht nga rreziqet shëndetësore, nga kontakti i drejtpërdrejtë me tokën e ndotur, avujt nga ndotësit ose nga ndotja dytësore e furnizimeve të ujit

brenda themelit të tokës. Materialet nga sipërfaqja e tokës mund të lëvizin nëpër tokë dhe të përfundojnë në ujërat nëntokësore. Për shembull, pesticidet dhe plehrat mund të gjejnë rrugën e tyre në furnizimin me ujë nëntokësor me kalimin e kohës. Përveç kësaj, është e mundur që mbeturinat e patrajtuara nga gropat septike dhe kimikatet toksike nga depozitat nëntokësore dhe deponitë e rrjedhura të ndotin ujërat nëntokësore.

Në raste të tilla për ta parandaluar ndotjen e tokës dhe ujërave nëntokësore të shkaktuara nga aktivitetet bujqësore, Komuna e Prishti-

nës përmes drejtorisë së Bujqësisë jep rekomandime dhe këshilla profesionale për grupet e interesit-fermerët, që të përdorin në mënyrë sa më profesionale pesticidet dhe plehrat artificiale në mënyrë që ndotja e tokës dhe ujit të jetë sa më e vogël. Ndërkaq Komuna e Suharekës për ta parandaluar një fenomen të tillë ndërmerr inspektime, monitorime dhe masa vetëdijesuese me fermerët.

Kurse në komunën e Mitrovicës për aktivitetet bujqësore që janë zhvilluar deri më tani nuk ka pasur ndonjë rekomandim nga Inspektorati Komunal ose i Ministrisë për ndonjë rast të caktuar që ka bërë keqpërdorim me preparate kimike gjatë aktiviteteve bujqësore.



2. MBËLTIMI DHE MIRËMBAJTJA E FIDANEVE TË REJA

2.1 MBËLTIMI I FIDANEVE TË REJA

Drunjtë përveç që luajnë rol në përmirësimin e klimës në lagjet tona si dhe i ndihmojnë mirëqenies së shëndetit të njeriut dhe ambientit, drunjtë mund të ndihmojnë edhe në krijimin e kushteve për përparim ekonomik.

Sipas këtij hulumtimi del se përgjatë periudhës 2018-2020

Komuna e Prishtinës ka kontribuar me mbëltim të 13,649 fidanëve, Komuna e Malishevës me 5,274 fidanë të mbëltuar, Komuna e Suharekës me 5,000 fidanë, Komuna e Gjilanit me 1,000 fidanë, Komuna e Mitrovicës me 1,356 fidanë. Komuna e Prizrenit gjatë tri viteve të

fundit ka mbëltuar një sasi prej 1,876 fidanë dhe Komuna e Gjakovës 2,000 fidanë. Llojet të cilat janë mbjellë kryesisht në rajonin e Kosovës janë: Bliri, Katalba, Rrapi, Shemshiri, Shelgu, Bredha, Acer Platanoides dhe lloje të ndryshme të shkurreve.

DRUNJTË DEKORATIVE/FIDANET QË JANË MBËLTUAR NË DISA NGA KOMUNAT E KOSOVËS

	2018	2019	2020 (01.01.2020- 01.07.2020)	GJITHSEJ	KOMENT
SUHAREKË		5000 COPË		5000 COPË	BLI, RRAP, KATALBA, KUMBULL DEKORATIVE, QERSHI DEKORATIVE, TUJA AKSIDENTALIS, BREDHI I ARGJENDËT, PISHA E ZEZË DHE E BARDHË DHE SHKURRE TË NDRYSHME.
MALISHEVË	-	5,120 COPË	154 COPË	5274 COPË	HEMESHIRA, KATALBA, BREDHA, TRËNDAFILA, SHELGJE, BLIRI, PLATANUS MIN., ACER PLATANOIDES, PISHA SMARAGD
PRISHTINË	1578 COPË		521 COPË	13,649 COPË	FIDANE DHE PEMË DEKORATIVE.
GJILAN	400 COPË	600 COPË	NUK ËSHTË PËRGJIGJUR	1000 COPË	ACER PLATENOIDES, BLI, CATALBA, PISHA DEKORATIVE DHE LLOJE TË NDRYSHME TË SHKURREVE.
MITROVICË	440 COPË	916 COPË	NUK ËSHTË PËRGJIGJUR	1356 COPË	LAURA (DRUNJË DEKORATIV).
PRIZREN		1876 COPË		1876 COPË	*INSTITUTI GAP HTTPS://WWW.KOMUNAT.INSTITUTIGAP.ORG/PREMTI MET/KRYETARET/86/MYTAHER%20HASKUKA
GJAKOVË	2000 COPË			2000 COPË	*INSTITUTI GAP HTTPS://WWW.KOMUNAT.INSTITUTIGAP.ORG/PREMTI MET/KRYETARET/64/ARDIAN%20GJINI

2.2 ANALIZAT FITOSANITARE

Ruajtja dhe mbrojtja e shëndetit bimor nuk është sfidë e një vendi të vetëm të një shteti, rajoni apo kontinenti, por është diçka më e gjerë.

Fidanët e sëmura të cilat mbillen janë ndër ndotësit më të mëdhenj të tokës dhe njëkohësisht edhe të ujit. Prandaj edhe institucionet përgjegjëse kanë degën e fito-inspektimit në të cilën mundohet që të minimalizohet futja e bimëve të sëmura në vendin tonë.

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, si institucion i ngarkuar me mandat ekzekutues të kontrollit, përveç tjerash, mbrojtjen dhe ruajtjen e shëndetit bimor brenda territorit të Republikës së Kosovës, përmes shërbimit fitosanitar, qoftë atij kufitar apo regional, kryen kontrolle të rregullta dhe monitoruese në bazë të planeve operative nacionale (Planit të Kontrollleve dhe Planit të Mostrimit). (Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë).

Në pyetjen të cilën EC e ka parashtruar për drejtoritë e Komunave, rreth çështjeve të inspektimit të fidanëve/drunjëve dekorative të hyra në Kosovë në tri vitet e fundit (2018,2019,2020) specifikisht sa prej tyre janë identifikuar të sëmura dhe sa përqind i janë nënshtruar analizave fitosanitare, nga disa komuna të cilat kanë qenë të përfshira në hulumtim (Komuna e Prizrenit, Pejës, Ferizajit dhe Gjakovës), EC nuk ka arritur që të merr fare përgjigje, ndërsa nga komunat e tjera (Suhareka, Prishtina, Malisheva, Mitrovica, Gjlani) nuk janë siguruar përgjigje të detajuara rreth pyetjes së parashtruar. Për këtë arsye EC ka vazhduar komunikimin përmes dërgimit të kërkesave të njëjta edhe tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë-Prishtinë.

Zyrtarë të AUV kanë bërë të ditur se importi i bimëve qoftë dekorative ose materiale të tjera mbjellëse, mund të lejohen vetëm atëherë kur

konstatohet se bimët dhe materialet e tjera bimore janë në përputhshmëri të plotë me legjislacionin nacional në fuqi. Kompanitë importuese duhet të jenë të licencuara në MBPZHR, si importuese (mundëson gjurmueshmërinë në rast të ndonjë lëshimi dhe shmangie eventuale nga importuesit). Vendi eksportues duhet të shoqëron detyrimisht bimët dhe produktet e caktuara bimore me certifikatë fitosanitare, që garanton se bimët dhe produktet bimore janë të lira dhe të prodhuara në zona të lira nga sëmundjet dhe dëmtuesit e karantinës. Nëse me analiza laboratorike konstatohet se fidanët e bimëve dekorative janë të infektuara (me insekte, sëmundje apo të ngjashme) atëherë veprohet sipas Ligjit (udhëzohet për trajtim apo asgjësim të bimëve në prezencën e Inspektoratit Fitosanitar). Kontrollat zyrtare bëhen sipas planit nacional, procedurat e inspektimit sipas ligjit. Në rast të dyshimit ose simptomave, merren mostrat për analiza laboratorike entomologjike dhe fitopatologjike.

(L.TH- Zyrtar për Informim/ AUV).



2.3 MIRËBAJTA E FIDANËVE NË HAPËSIRA URBANE

Fidanët duhet të konsiderohen si kontribues të shëndetit publik andaj edhe investimi dhe mirëmbajtja e tyre duhet të hyj në kategorinë e kontributit ndaj mirëqenies publike. Prandaj edhe investimi për mirëmbajtjen e tyre duhet të jetë i vazhdueshëm.

Gjelbërimi apo mbjellja e fidanëve nëpër hapësira publike është përgjegjësi e çdo komune. Më e rëndësishmja është që ato fidane të mirëmbahen dhe të kenë një jetëgjatësi.

Derisa Komuna e Prizrenit, Pejës, Ferizajit dhe Gjakovës nuk i janë përgjigjur kërkesës së EC-it sa i përket pyetjes se si mirëmbahen nga ana e komunës fidanët e mbjellura (krasitje, ujitje) dhe si bëhet përzgjedhja e kompanive për mirëmbajtje, Komuna e Suha-

rekës, Malishevës, Mitrovicës dhe Gjilanit janë deklaruar që mirëmbajtja e fidanëve bëhet nga kompanitë përfituese përmes tenderimit me kontratë 1-2 vjeçare dhe operatorët ekonomik janë të detyruar që të bëjnë zëvendësimin e fidanëve të thara brenda afatit kohor të kontratës së nënshkruar.

Ndryshe nga këto komuna, Prishtina ka deklaruar që punën e mirëmbajtjes e kryen ndërmarrja publike lokale "Hortikultura" Sh.A e cila kryen të gjitha intervenimet e nevojshme përfshirë ujitjen sistematike nga pusët e hapura apo cisternat ku një gjë e tillë nuk është e mundur, krasitjet për rritje, prashitjen e dheut apo spërkatjen me preparat kur një gjë e tillë konstatohet se është e nevojshme.

3. MONITORIMI DHE MENAXHIMI I MBETURINAVE TË NGURTA DHE ATYRE MJEKËSORE

Mbeturinat janë produkt i proceseve të vazhdueshme zhvillimore si urbanizimi, zhvillimi ekonomik dhe rritja e popullsisë. Gjatë këtyre proceseve ofrohen numër më i madh i produkteve dhe shërbimeve për qytetarët, tregti dhe shkëmbim më i madh në nivel global, të cilat kontribuojnë në rritjen e sasisë së mbeturinave. Në nivel global 2.01 miliardë ton mbeturina të ngurta gjenerohen në vit, dhe deri në vitin 2050 pritet që kjo sasi të rritet për 70% me trendin aktual, përkatësisht 3.4 miliardë ton.

Mbeturinat nga ndërtimi dhe demolimi përbëjnë vëllimin më të madh të mbeturinave në shtetet e BE-së. Vlerësohet se rreth 30% e sasisë totale të mbeturinave janë mbeturina nga ndërtimi dhe demolimi. Gjatë jetës llogaritet se një qytetar evropian gjeneron rreth 160 ton mbeturina nga ndërtimi dhe demolimi, e që është trend në rritje. Edhe pse masa më e madhe e kësaj kategorie të mbeturinave është e riciklueshme dhe mund të rishfrytëzohet, besimi në kualitetin e këtyre materialeve mbetet një nga sfidat më të mëdha.

Ligji nr.04/L-060 për mbeturina në Kosovë klasifikon mbeturinat sipas llojit në katër kategori

- **Mbeturina komunale;**
- **Mbeturina industriale;**
- **Mbeturina komerciale;**
- **Mbeturina medicinale;**

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave të ngurta vazhdon të jetë i paqëndrueshëm sipas raportit të fundit të progresit nga Komisioni Evropian. Korniza ligjore është pjesërisht e përafuar me acquis të BE-së, por legjislacioni sekondar është ende i nevojshëm për të zgjeruar përgjegjësinë e prodhuesit dhe parimin ndotësi paguan. Ligji për mbeturinat duhet të harmonizohet më tej me Direktivën Kornizë të Mbeturinave. Zbatimi është i mangët dhe shumica e mbeturinave përfundojnë në deponi që nuk menaxhohen si duhet, ose të paligjshme. Pavarësisht përpjekjeve për t'i mbyllur deponitë ilegale, ato vazhduan të përhapen (nga 1,572 në vitin 2017 në 2,529 në vitin 2019) dhe përbëjnë rrezik serioz për shëndetin publik, veçanërisht për shkak të mbetjeve të rrezikshme dhe ndotjes së



ujërave nëntokësore. Parandalimi dhe monitorimi i mbetjeve mbetet një sfidë. Shkalla aktuale e grumbullimit është 70% dhe më pak se 40% e mbetjeve të ngurta hidhen në objektet e menaxhuara. Parandalimi dhe monitorimi i mbetjeve mbetet një sfidë. Shkalla aktuale e grumbullimit është 70% dhe më pak se 40% e mbetjeve të ngurta hidhen në objektet e menaxhuara. Kosova duhet të prezantojë masa ligjore dhe praktike për të zvogëluar mbeturinat dhe për të rritur riciklimin dhe rikuperimin në përputhje me parimet e ekonomisë rrethore.

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf

Nga kërkesa e parashtruar e EC rreth monitorimit dhe menaxhimit të mbeturinave të ngurta dhe mjekësore, del se në Suharekë mbeturinat e ngurta të ndërtimtarisë deponohen në deponitë legale në Shirokë, ndërsa ato mjekësore menaxhohen nga personeli mjekësor me sistemin e 3 koshave dhe insiniratorët adekuat (për djegien).

Komuna e Prishtinës problemën e menaxhimit të mbeturinave inerte (konstruktion demolimi), del se e ka si problem shumë të madh për shkak të mungesës së një deponie apo qendër për trajtimin e këtij lloji të mbeturinave.

Në mungesë të deponisë përkatëse komuna e Prishtinës në kuadër të DSHPMSh dhe sektorit të Menaxhimit të Mbeturinave dhe Ambientit këtë lloj të mbeturinave e trajton në mënyrë të vazhdueshme në kuadër të menaxhimit të mbeturinave komunale. Këto mbeturina në rastet kur hedhen në afërsi të kontejnerëve të mbeturinave të amvisërisë i largon kompania KRM "Pastrimi".

Në bazë të Ligjit për Mbeturina dhe Rregullores Komunale për Mbeturina 03/2016, Komuna e

Mitrovicës, menaxhon me mbeturina Komunale (grumbullim, transportim dhe deponim në deponinë sanitare në Gërmovë) dhe mbeturina inerte nga konstruksionet e demolimit për të cilat komuna e Mitrovicës është komuna e parë që ka hartuar planin dhe ka caktuar lokacionin e veçantë për deponimin e këtyre mbeturinave të miratuara në Kuvend të Komunës. Mbeturinat toksike dhe mjekësore nuk menaxhohen nga Komuna mirëpo në Mitrovicë, Ministria e Mjedisit ka instaluar një Incenerator për djegien e mbetjeve medicinale në oborrin e spitalit të përgjithshëm rajonal, ku në mënyrë të rregullt mbeturinat medicinale digjen sipas standardeve.

Menaxhimin dhe monitorimin e mbeturinave të ngurta Komuna e Malishevës e ka problem të theksuar. Kjo komunë e ka vetëm një vendim të asamblesë komunale për caktim të lokacionit ku munden qytetarët ta shfrytëzojnë për hudhjen e mbeturinave të ngurta. Për ato mjekësore dhe toksike që mund të krijohen nga QKMF--ja dhe QMF-të ato mblidhen nga kompani të cilat janë të kontraktura nga Ministria e Shëndetësisë.

4. PRERJET DHE ZJARRET ILEGALE PYJORE

4.1 PRERJET ILEGALE PYJORE

Kosova ka ndërmarrë hapa për të filluar inventarizimin, hartëzimin e habitateve natyrore dhe biodiversitetit, por përcaktimi i vendeve Natura 2000 është ende në fazën shumë të hershme për shkak të mungesës së kapacitetit administrativ. Pak progres është bërë në pylltari për sa i përket planifikimit dhe menaxhimit, me miratimin e akteve përkatëse sekondare. Shpyllëzimet dhe prerjet ilegale të drurëve mbeten problematike. (https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf)

Referuar bazës ligjore që rregullon sektorin e pylltarisë në përgjithësi dhe komponentën e mbrojtjes në veçanti sipas ligjit, 03/L-153 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Pyje, Nr. 2003/3 kompetencat e mbrojtjes së pyjeve në aspektin e përgjithshëm, pra edhe mbrojtjen nga zjarret, janë përgjegjësi të deleguara nga autoritetet qendrore: "Agjencioni Pyjor i Kosovës" tek nivelet komunale. Po sipas këtij ligji dhe Udhëzimeve Administrative është e rregulluar edhe çështja e Neni, 12 paragrafi,

29. 12 nënparagrafët, c dhe d të ligjit të lartëcekur specifikojnë detyri- met e Komunave për raportime mujore nga fushë-veprimtaria e këtij shërbimi, si dhe obligimin që kanë komuna që së paku një herë në vit të bëjnë regjistrimin e terreneve ekonomiko-pyjore. (Agjencia e Pylltarisë së Kosovës).

Sipas përgjigjeve që kemi arritur ti marrim nga disa Komuna të Kosovës për veprime ilegale në pyje dhe toka pyjore, janë ngritur fletëparaqitje penale dhe kundërvajtëse nga këto komuna si më poshtë:

	2018		2019		2020(JANAR-QERSHOR)	
GJAKOVË	397	647.02	168	294.82	92	152.17
SUHAREKË	173	338.51	141	245.59	43	98.82
FERIZAJ	515	1574.23	480	777.32	206	345.17
MALISHEVË	113	141.33	79	97.11	80	118.83
MITROVICË	111	-	64	-	19	-
PEJË			11 COPË			
GJITHSEJ	GJAKOVË 657 COPË 1094.01 M ³	SUHAREKË 357 COPË 682.92 M ³	FERIZAJ 1001 COPË 2696.72 M ³	MALISHEVË 272 COPË 357.27 M ³	MITROVICË 194 COPË	PEJË 11 COPË

Derisa Komunës së Prizrenit, Prishtinës dhe Gjilanit nuk kemi arritur t'i qasemi në informata rreth çështjes së prerjeve ilegale dhe dëmtimit të pyjeve, komunat e lartpërmendura në tabelë, me një saktësi dhe shifra detajuese na kanë njoftuar rreth atyre rasteve që janë ndëshkuar për veprime ilegale nëpër pyjet tona. Nga të dhënat e fituara, Komuna e Ferizajit me 1,001 fletëparaqitje kundërvajtëse dhe penale në tri vitet e fundit ka qenë komuna që ka bërë më

së shumti inspektime dhe është kujdesur për mosdëmtimin e pronës sonë publike nga dëmtuesit e papërgjegjshëm. Komunën e Ferizajit e përcjellin me rend Komuna e Gjakovës me 657 fletëparaqitje, Komuna e Suharekës me 357 fletëparaqitje, Komuna e Malishevës me 272 fletëparaqitje dhe Komuna e Mitrovicës me 194 fletëparaqitje. Kurse Komuna e Pejës është deklaruar që në tri vitet e fundit i ka identifikuar vetëm 11 prerje ilegale dhe nga këto 11 raste, 6

(gjashtë) prej tyre i janë iniciuar procedurave gjyqësore ndërsa 5 (pesë) prej tyre mbeten të paidentifikuara.

Vlen të theksohet edhe vlera në Euro e dëmeve të shkaktuara si pasojë e veprimeve ilegale. Në Komunën e Gjakovës nga këto veprime ilegale në tri vitet e fundit, dëmet e shkaktuara kanë qenë në vlerë prej **888,800.61 Euro** dhe në komunën e Malishevës prej **57,190.56 Euro**.

4.2 ZJARRET PYJORE TË IDENTIFIKUARA NË DISA NGA KOMUNAT E KOSOVËS PËRGJATË TRI VITEVE TË FUNDIT

Zjarret në pyje mund të shkaktohen nga vetë dukuritë natyrore ose nga faktori njeri. Nga faktorët natyrorë që ndikojnë në përhapjen e zjarreve mund të përmendim temperaturat e larta, rrufetë ose shpërthimet e ndryshme tokësore. Kurse zjarret që paraqiten si pasojë e veprimit të njeriut zakonisht vijnë nga pakujdesia dhe neglizhenca. Gjuajtja e filtrave të duhanit pa i shuar mirë, mosshuarja e zjarreve gjatë kampeve, piknikëve apo veprimeve të tjera në natyrë, gjuajtja e qelqit në mjedis që luan rolin e zjarrnxitësit, mund të përmenden si disa nga faktorët njeri që ndikojnë në hapjen e zjarreve pyjore.

Çdo zjarr sadoqoftë përmasa e tij shkakton dëme të mëdha ekologjike. Shkatërrimi i mbulesës së gjelbër në zonën ku është përhapur zjarri, dëmtimi i habitateve të bimëve dhe kafshëve, zhdukja e llojeve të ndryshme të insekteve, kafshëve dhe mospyllëzimi i zonave të dëmtuara janë disa nga pasojat që shkaktojnë zjarret pyjore në ekosistem. Por më e rëndësishmja është që ndikon edhe në ndryshimet klimatike dhe në krijimin e thatësirës. Zjarret pyjore viteve të fundit kanë qenë sfida me të cilat janë ballafaquar komunat e Kosovës, ku për parandalimin e tyre përmes APK-së (Agjencia e - Pyjeve të Kosovës) janë krijuar memo-

randume bashkëpunimi edhe me institucionet tjera të cilat kanë dhënë rezultat në parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje. APK në bashkëpunim me MMPS, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ka pranuar punëtorë sezonal, ku të njëjtit në bashkëpunim mes APK-së dhe AME janë trajnuar dhe certifikuar për shuarje të zjarreve në pyje. Andaj edhe zjarret të cilët kanë qenë në pyje nuk kanë qenë zjarre të larta - zjarre me përmasa shkatërruese në pyje, por kryesisht kanë qenë zjarre me intensitet të ulët, apo zjarre të ulëta dhe të mesme, si dhe një pjesë e tyre në toka pyjore (kullosa apo sipërfaqe të hapura). (Agjencia e Pylltarisë së Kosovës).

Në tabelën në vijim janë të paraqitura vlerat e sipërfaqeve të djegura pyjore në hektar për tri vitet e fundit, të disa komunave të Kosovës, të dhënat e të cilave i kemi siguruar nga drejtoritë përkatëse të komunave:

DREJTORITË KOORDINUESE REGJIONALE	SIPËRFAQJA/HA (VITI 2018,2019,2020 JANAR -QERSHOR)
PEJË	138
GJAKOVË	1289
SUHAREKË	300
MALISHEVË	154.2
FERIZAJ	61.50
MITROVICË	455.1*
PRIZREN	-
PRISHTINË	-
GJILAN	-
TOTALI	2397.8 HA

*(2018,2019)

Disa ndër masat që Komunitat e lartpërmendura i kanë ndërmarrë për parandalim të këtyre zjarreve kanë qenë:

- Intervenimi në shuarjen e zjarreve në bashkëpunim me njësinë e zjarrfikësve, si dhe bashkëpunimi me qytetarët lokal për mbrojtje nga zjarret.
- Shtimi i kujdesit të rojeve të pyllit dhe stafit tjetër në parandalimin e zjarrvënësve nëpërmjet vëzhgimit të terrenit, kontrolleve më të shpeshta dhe shtimit të vigjilencës dhe bashkëpunimit me banorët lokal.
- Marrja pjesë në shuarjen e zjarreve të rojeve, zjarrfikësve si dhe punëtorëve sezonal të cilët kanë qenë të angazhuar nga Agjencioni Pyjor i Kosovës.

4.3 PYLLËZIMI I TOKAVE TË DËMTUARA NËPËR KOMUNA NË TRI VITET E FUNDIT

Prerjet ilegale, zjarret e paraqitura nga faktori njeri apo nga vetë dukuritë natyrore i dëmtojnë jashtëmase pyjet bashkë me ekosistemin e tyre. Derisa pyjet janë frymë për botën tonë, ato janë edhe vatër apo shtëpi të shumë gjallesave të tjera. Rritja e shkallës së shkatërrimit të biodiversitetit, florës dhe faunës, zhdukjes së qinda mijëra llojeve na paralajmëron për një botë jo të banueshme në një të ardhme të afërt. Ajo që më së shumti duhet të kontribuojmë është mundimi maksimal për ruajtjen e thelbit të frymëmarrjes ose parandalimin e shkatërrimit të pyjeve. Ripyllëzimi është njëra nga mënyrat që do t'i ndihmonte pyjeve për rigjallërim të zonave të dëmtuara.

Në komunat e Kosovës ripyllëzimi bëhet sipas planit ose projekteve të parapara nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës sipas të cilëve bëhen pyllëzimet pranverore dhe vjeshtore. Sipas të dhënave që kemi arritur ti sigurojmë nga disa komuna të Kosovës, të cilëve i'u kemi parashtruar kërkesën rreth asaj që sa përqind e tokave të dëmtuara janë ripyllëzuar, kemi marrë këto përgjigje: Derisa Komuna e Pejës, Mitrovicës dhe Malishevës janë përgjigjur se në tri vitet e fundit nuk kanë pasur ndonjë pyllëzim, Komuna e Suharekës ka deklaruar që në tri vitet e fundit janë pyllëzuar 21 ha tokë në këto vende: Fshatin Mushtisht në vendin e quajtur Rudinë dhe në fshatin Bllacë, Komuna e Ferizajit ka

pyllëzuar 5 hektarë tokë me pishë në fshatin Pleshinë e Epërme, kurse komuna e Gjakovës 50 Ha. Komuna e Prizrenit, Gjilanit dhe Prishtinës nuk i janë përgjigjur kërkesës tonë.

Nga të dhënat e fituara nga Komuna e Pejës, Gjakovës, Suharekës, Malishevës, Ferizajit dhe Mitrovicës del që nëpër këto zona në tri vitet e fundit derisa janë paraqitur zjarre në një sipërfaqe prej 2397.8 hektar, sipërfaqet që janë ripyllëzuar nuk e kanë kaluar as 80 hektar tokë. Rekomandojmë institucionet përkatëse moslënien pasdore të pyllëzimit të zonave të dëmtuara duke u kujdesur që ti ruajmë dhe ti shërojmë pyjet të cilat janë pronë e gjithë shoqërisë.

5. PROFESIONISTËT MJEDISOR

Në Kosovë çdo ditë e më shumë po rritet vetëdijesimi rreth mbrojtjes së ambientit dhe rreth vlerave të saj. Këtë e vërteton më së miri edhe fakti i hapjes së drejtimeve të reja në institucionet universitare dhe nga shumica e organizatave që fushëveprimin e kanë kthyer në mbrojtjen e vlerave mjedisore. Në kërkesën rreth numrit të të punësuarve me profesion mjedisi në institucionet publike, EC ka pranuar nga komunat këto përgjigje:



KOMUNA E PRISHTINËS

DSHPMSH brenda drejtorisë ka sektorin e veçantë që është Sektorin për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit në të cilin është i punësuar Zyrtari i Lartë për Ambient

Drejtorja për Planifikim dhe Zhvillim Strategjik, në kuadër të të cilës drejtori gjendet Sektorin i Mjedisit në të cilin ka tre zyrtarë profesionistë të mjedisit

Drejtorja e Parqeve e cila lidhet drejtpërdrejtë me menaxhimin e hapësirave të gjelbra e të cilat kanë ndikim në cilësinë e ajrit.

KOMUNA E SUHAREKËS

Pesë (5)
punëtorë me
profesion
mjedisi

KOMUNA E SUHAREKËS

Një (1)
Punëtor me
profesion
mjedis

KOMUNA E MALISHEVËS

Zyrtar i lartë për
menaxhimin e
mbeturinave
(Një punëtorë)

Inspektorë të
ambientit
(Dy punëtorë)

6. REKOMANDIME

1 Inkurajimi i një tranzicioni në qytete që mbështesin dhe promovojnë mënyra jetese të shëndetshme për individë dhe planetin. Hapat për t'a arritur këtë, përfshijnë zhvillimin e transportit aktiv me kosto të ulët dhe rritjen e aksesit në hapësirat e gjelbërta. Masa të tilla përmirësojnë kapacitetin adaptues, ndërsa ulin gjithashtu ndotjen urbane, emetimet e gazrave serë dhe normat e sëmundjeve kardiovaskulare, kancerit dhe sëmundjeve të frymëmarrjes;

2 Sipas Raportit të Progresit 2020, në vitin e ardhshëm, Kosova inkurajohet:

- të rritë në mënyrë të konsiderueshme ambicinet drejt një tranzicioni të gjelbër dhe në veçanti duhet:
- të krijojë një sistem efektiv të monitorimit të ujërave, të publikojë të dhëna dhe të ndër marrë masa urgjente dhe të përhershme për të zvogëluar ndotjen e ajrit dhe ujërave;
- të vazhdojë rritjen e mbulimit të grumbullimit të mbeturinave, veçanërisht me futjen e ndarjes së mbeturinave dhe riciklimin e tyre, futjen e

- ndarjes së mbeturinave dhe riciklimin e tyre, futjen e masave të ekonomisë rrethore për të zvogëluar mbeturinat dhe adresimin e çështjes së deponive të paligjshme;

- të zbatojë dispozitat ligjore për përgjegjësinë, dëmtimin dhe krimin mjedisor; zbatimin e parimit ndotësi paguan, krijimin dhe fillimin e një fushate të përhershme për rritjen e ndërgjegjësimin të publikut për mbrojtjen e mjedisit;

3 **Drunjtë në qytetet urbane:** Drunjtë janë pjesë e zgjidhjeve për shumë sfida të rëndësishme të kohës sonë, që nga ndryshimi klimatik deri te shëndeti dhe mirëqenia në rënie. Si pjesë vitale e infrastrukturës urbane, drunjtë ofrojnë një llojllojshmëri përfitimesh: hije në verë, strehë nga shiu dhe era, ndihmojnë ta mbajmë ajër më të pastër dhe të mund të marrim frymë, e ndihmojnë botën e egër dhe i shtojnë vlerë kulturës dhe ekonomisë së qyteteve tona. Ruajtja dhe



mosdëmtimi i drunjëve ekzistues dhe mbëltimi i fidanëve të rinjë në konsultim me ekspertë, duke e përshtatur nevojën specifike të hapësirës me llojin e mbëltuar është përgjegjësi e çdo komune për një zhvillim urbanistik të mirëfilltë.

4 **Menaxhimi i mbeturinave:** Në mënyrë që të eliminohen efektet negative të mbetjeve të prodhuara, mbeturinat duhet t'i nënshtrohen një procedure të caktuar të trajtimit. Ligji nr. 02/L-30 për mbeturina në Kapullin 2, Nenin 5 posedon parimet themelore për administrimin e mbeturinave. Administrimi i mbeturinave bëhet sipas sistemit të prioriteteve (hierarkisë) i cili në praktikë, bëhet sipas kësaj radhitje:

Parandalimi ose zvogëlimin i prodhimit të mbeturinave dhe karakteristikave të rrezikshme, duke përfshirë edhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave të prodhuara më parë; trajtimi i mbeturinave me metoda që mundësojnë ripërdorimin e plotë ose të

pjesshëm të mbeturinave, riciklimin e mbeturinave, shfrytëzimin e vlerave të dobishme të mbeturinave (përfshirë kompostimin, shfrytëzimin e mbeturinave si burim energjie etj), incenerim pa përfitim të energjisë (trajtimi termik), dhe së fundmi deponimin e mbeturinave në deponi pa shkaktuar ndikime të dëmshme në mjedis.

Mbetjet apo mbeturinat janë rezultat i aktiviteteve tona të përditshme dhe një pjesë e pashmangshme e jetës, por menaxhimi i tyre sipas hierarkisë së lartpërmendur do të ndihmonte në zgjidhjen e problemeve globale mjedisore që shkaktohen nga jotrajtimi i duhur. Por gjithashtu prezantimi i masave ligjore dhe praktike për të zvogëluar mbeturinat dhe për të rritur riciklimin dhe rikuperimin në përputhje me parimet e ekonomisë rrethore do të luante një rol të rëndësishëm në vetëdijësimin e institucioneve dhe qytetarëve.

5 Ndarja, klasifikimi dhe asgjësimi i mbeturinave mjekësore pa shkaktuar pasoja për ambientin apo njerëzit; Mbeturinat mjekësore mund të shkaktojnë sëmundje dhe lëndime të ndryshme për shkak të vetive të tyre të rrezikshme. Por gjithashtu

mbetjet mjekësore paraqesin vështirësi të ndryshme si në grumbullimin, transportimin dhe asgjësimin për shkak të këtyre veçorive. Këto lloje të mbeturinave, ndryshe nga mbeturinat shtëpiake, sidomos nga punonjësit shëndetësor duhet të grumbullohen ndaras. Mëqë këto mbeturina hyjnë në kategorinë e mbetjeve të rrezikshme, asgjësimi i tyre duhet të bëhet me metoda të ndryshme duke bërë djegien e tyre në vende adekuate për asgjësim ose para hudhjes duke bërë sterilizimin e tyre. Neni 29 i Ligjit Nr. 02/L-30 për mbeturina na udhëzon rreth rregullave të grumbullimit, klasifikimit, deponimit apo asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme.

6 Parandalimi i shkatërrimit të pyjeve dhe ripyllëzimi- Pavarësisht nga përfitime të shumta që sjellin pyjet tek ne, ato po shkatërrohen dita ditës për arsye të ndryshme. Por edhe ripyllëzimi po përfshinë shumë më pak hapësirë se zonat e shkatërruara. Bashkë me ripyllëzimin e zonave të dëmtuara duhen ndërmarrë edhe masa mbrojtëse. Masat që duhen ndërmarrë për mbrojtjen e pyjeve mund t'i klasifikojmë në dy grupe:

- Masat mbrojtëse dhe
- Masat e ndërhyrjes

Masat mbrojtëse kanë për qëllim që t'i mbajnë larg dëmtuesit e pyjeve. Kurse masat e ndërhyrjes përpiqen të eliminojnë shkaqet e dëmtimit të pyllit ose të paktën të zvogëlojnë ashpërsinë e këtij dëmtimi dhe të sigurojnë kushtet e nevojshme që pylli të mbijetojë.

7 Shtim i inspektorëve të terrenit - rritje e kampanjave vetëdijesuese për pasojat;

Çdo person që është i njoftuar për dëmtim të mjedisit ose për aksident mjedisor, duhet të njoftojë Inspektoratin për mbrojtjen e mjedisit ose organin tjetër përgjegjës sipas Ligjit Nr. 03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit, Neni 39. Shtimi i numrit të inspektorëve mjedisor në terren mundëson qëndruesh- mërinë ose mosshkeljen e masave të marra për mbrojtje të mjedisit. Por gjithashtu parandalon veprimet e dëmshme në mjedis. Rritja e numrit të inspektimeve dhe kontrollave nga ana e institucioneve dhe zbatimi i parimit “Ndotësi paguan” do të ndikonte njëkohësisht edhe vetëdijësimin e qytetarëve për mbrojtjen e vlerave natyrore të cilat janë pronë e gjithë shoqërisë.

PËR EC

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikqërjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme: 1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale, 2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe 3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 – 2024) ka këto elemente:

1. Gjithëpërfshirjen, 2. Qëndrueshmërinë, dhe 3. Dijen. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga posht lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;
2. Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyer përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
3. Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura dhe
4. Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.